

Njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë të vetëm nga KJK III Holding 1 S.a.r.l., Luksemburg, mbi KOLPA Prodhim dhe Përpunim të Materialeve Plastike, d.o.o. Metlika, Slloveni (lënda nr. 08-78 /2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 16.04.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin KJK III Holding 1 S.a.r.l. me adresë të regjistruar në 94, rue du Grunevald, L-1912, Luksemburg synon të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë të vetëm mbi KOLPA Prodhim dhe Përpunim të Materialeve Plastike, d.o.o. Metlika me seli të regjistruar në Rosalnice 5, 8330 Metlika dhe në mënyrë të tërthortë mbi shoqëritë të varura të KOLPA (“Grupi KOLPA”) përmes shitblerjes së pjesëve.

-KJK III Holding 1 S.a.r.l. është një shoqëri me qëllim të veçantë e themeluar në dhjetor 2024 si shoqëri e varur në pronësi të plotë të KJK III Participations S.a.r.l., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që është 100% në pronësi dhe e kontrolluar nga fondi investues i luksemburgit KJK Fund III SCA, SICAV-RAIF, fond alternativ investimi i formuar si shoqëri investuese me kapital të ndryshueshëm (“KJK Fond III”). Qëllimi investues i KJK III Holding 1 S.a.r.l. është të ndërtojë një portofol të larmishëm përmes investimeve të drejtpërdrejta në kapitalin bazë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme publike dhe private.

Parashtruesi i Njoftimit vlerëson se KJK Fond III është një fond i pavarur që ushtron kontroll të vetin. Vendimet në lidhje me politikën investuese dhe aspekte të tjera të funksionimit të Parashtruesit të Njoftimit i nënshtrohen kontrollit të Kuvendit të Përgjithshme të investitorëve të KJK Fond III. Grupi i kompanive që i përkasin të njëjtit grup si KJK Fond III duhet të kuptohet në këtë kontekst, si dhe si kompanitë mbi të cilat KJK Fond III ushtron kontroll.

KJK Fond III nuk ka prezencë korporative në Maqedoninë e Veriut.

KJK Fond III ka realizuar të ardhura shumë të kufizuara në tregun maqedonas përmes dy kompanive të portofolit të tij, por jo në tregun relevant të propozuar.

-KOLPA Prodhim dhe Përpunim të Materialeve Plastike, d.o.o. Metlika është një nga prodhuesit kryesorë të pajisjeve për banjo në Evropën Qendrore dhe Juglindore. Grupi KOLPA është i pranishëm në më shumë se 45 vende të botës, me aktivitetet e tij të ndara në katër programe:

- Programi Kolpaskan, në kuadër të të cilit KOLPA prodhon pajisje për banjo, përkatësisht vaska, dushe, xhakuzi me ujë të ngrohtë, vaska me xhakuzi me ujë të ngrohtë, vaska me masazhues, kabina me masazhues, kabina dushi, mobilje për banjo dhe aksesore për banjo.
- Programi Kerrock, në kuadër të të cilit KOLPA prodhon panele kompozite, produkte kompozite dhe përpunon materiale kompozite.
- Programi Kolpa Solutions, i cili ofron zgjidhje nga koncepti deri te implementimi i projektit.

- Programi Unique, në kuadër të të cilit KOLPA shet mobilje të personalizuar për banjo. Programi u lançua në shtator 2024.

Grupi KOLPA nuk ka prezencë korporative në Maqedoninë e Veriut.

Grupi KOLPA ka realizuar të ardhura shumë të kufizuara në tregun maqedonas.

Transaksioni i propozuar përbën implementim të politikës investuese të KJK Fond III për krijimin e një portofoli të larmishëm përmes investimeve të drejtpërdrejta në kapitalin pronësor të kompanive publike dhe private që janë prodhues të orientuar drejt eksportit në Evropën Lindore dhe Qendrore.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr.54, Shkup ose në e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të mbërrijnë pranë Komisionit brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

23.04.2025

Shkup